

Të gjithë duhet të japin maksimumin për përmbushjen e standardeve

Intervistë me kryeministrin z. Bajram Rexhepi

Kryeministri i Kosovës z. Bajram Rexhepi flet për standardet dhe rrugën drejt plotësimin të tyre. Sipas tij, secili qytetar i Kosovës mund të ndihmojë këtë proces tanimë të filluar që do të duhej të çonte drejt një jete më të mirë për të gjithë

Inervistoi: Edita Buçaj

Z. Kryeministër, si udhëheqës i qeverisë së Kosovës, sa janë në gjendje institucionet vendore t'i plotësojnë standardet e vëna nga bashkësia ndërkombëtare?

Kryeministri: Standardet e vëna nga bashkësia ndërkombëtare synojnë një përmirësim të vazhdueshëm të institucioneve vendore. Që në fillim kemi cekur se standardet janë të domosdoshme dhe institucionet vendore janë të përkushtuara në plotësimin e tyre. Gjithashtu që nga fillimi kam cekur se standardet mund të plotësohen në një masë të konsiderueshme dhe se maksimumi duhet të bëhet nga të gjithë për përmbushjen e tyre. Gjithmonë duhet mbajtur në mend se institucionet tona janë të parat të zgjedhura me votën e lirë të popullit, por për herë të parë janë në funksion të tillë dhe kjo duhet pasur parasysh.

Çfarë vlerësimi mendoni se do të marrin ato (institucionet) për punën e bërë në këtë drejtim në mesin e vitit të ardhshëm, duke pasur parasysh se zgjedhjet po afrohen dhe

NË KËTË NUMËR:

Për çka flet standardi i parë? fq. 3

Augustin Palokaj, standardet në media fq. 4-5

Zgjedhjet 2004 organizohen nga vendorët fq. 7

Nuk ka demokraci pa qeveri të fortë lokale fq. 8



"Të gjitha standardet kanë sfidat e veta, megjithatë, standardi i kthimit është më delikat ..." thotë kryeministri i Kosovës Bajram Rexhepi.

fushata mund të marrë një pjesë të energjisë së tyre?

Kryeministri: Nuk mund të flas për të gjitha institucionet, por në veçanti flas për kabinetin Qeveritar. Pas diskutimit për domosdoshmërinë e standardeve, kemi arritur një marrëveshje që funksioni i Qeverisë si i tillë do të vazhdojë deri në zgjedhje. Fushata elektorale do të fillojë e të zhvillohet dhe do të ketë angazhime në të, megjithatë, puna institucionale duhet të vazhdojë dhe do të vazhdojë deri në zgjedhje.

Sipas jush cili është standardi më i vështirë për tu plotësuar dhe pse?

Kryeministri: Të gjitha standardet kanë sfidat e veta, megjithatë, më delikat është stan-

dardi i kthimit, pasi që përveç kushteve të cilat duhet të plotësohen në Kosovë, është edhe vullneti i komuniteteve për kthim. Standard me rëndësi të veçantë për zhvillimin e gjithmbarshëm në Kosovë është edhe standardi i ekonomisë. Zhvillimi ekonomik në Kosovë nuk ka shënuar ndonjë progres. Përkundrazi, ka ngecje në këtë zhvillim për një kohë të gjatë.

Sa e vështirëson përmbushjen e standardeve mospjesmarrja e komunitetit serb në këtë proces?

Kryeministri: Mospjesmarrja e komunitetit serb në Kosovë ka qenë problematike që prej fillimit të procesit të standardeve. Një abstenim i tillë është i dëmshëm për të gjithë në Kosovë, por në veçanti për komunitetin serb. Në mënyrë që të shqyrtohen çështjet që rëndojnë këtë komunitet dhe ato të komuniteteve tjera, duhet që ata të jenë pjesë e procesit. Megjithatë, ende ka hapsirë dhe mundësi për inkuadrim të komunitetit serb në këtë proces dhe shpresojmë se pas asaj çka ndodhi në Kosovë është vlerësuar se nevojitet një dialog i mirëfillte në mes të komuniteteve në Kosovë.

A qëndron pohimi se standardet janë vënë me qëllim që të prolongohet zgjidhja e statusit të Kosovës apo ato me të vërtetë janë rruga drejt Europës?

Kryeministri: Standarde nuk ka vetëm Kosova pa status të definuar final. Standarde kanë edhe vendet me status të definuar të cilat synojnë integrimin Evropian. Prandaj standardet për Kosovën janë vetëm hapi i parë, drejt rrugës për integrimin Evropian. Përmbushja e standardeve duhet të shihet si diçka që drejtpërsëdrejti i kontribuon realizimit të statusit sipas vullnetit të popullit, afrimin më të madh të Kosovës drejt Bashkimit Evropian dhe bërjes së Kosovës një vend funksional e demokratik.

(Për më shumë informata: www.pm-ksgov.net)

Të flasim për Kosovën

Gjatë tetë javëve të ardhshme UNMIK-u dhe Zyra e Kryeministrit do të jenë të involvuara në fushatën për informim për të ngritur vetëdijen mbi 'Standardet për Kosovën'. Java e parë i kushtohet standardit të parë – funksionimi i institucioneve demokratike. Ky botim i veçantë i Detajeve, fletuskë e botuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë si shtyllë për ndërtimin e institucioneve, i kushtohet përshkrimi të mëturjeshëm të këtij standardi me fjalë dhe koncepte të kuptueshme për të gjithë.



Të dashur lexues,

Para jush janë hapat më të rëndësishëm, mbase edhe më të vështirët për zhvillimin e Kosovës. Plani për implementimin e standardeve – një partneritet në mes të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes (IPVQ) dhe UNMIK-ut, i paraqitur në fund të vitit të kaluar, parasheh shtegun të cilin duhet ta kalojë populli i Kosovës për tu bërë pjesë e familjes evropiane.

Standardet janë të rëndësishme jo vetëm për faktin që një progres i tillë do të shënojë fillimin e shqyrtimit të statusit final të



Kosovës, por në veçanti sepse kjo do të thotë përmirësim i çdo fushe të jetës për të gjithë në Kosovë. Plotësimi i standardeve kërkon angazhim të vendosur dhe përpjekje të vazhdueshme të të gjitha shtresave të shoqërisë, duke përfshirë institucionet vendore, shoqërinë civile, mediat si dhe çdo individ. Për të pasur sukses në përmirësimin e standardeve duhet të ketë përpjekje individuale dhe kolektive.

Në këtë fazë, institucionet dhe shoqëria e Kosovës mund të llogarisin në përkrahjen e misionit të OSBE-së në Kosovë. Ne jemi të gatshëm të ofrojmë këshilla dhe të ndihmojmë në ndërtimin dhe forcimin e kuadrove esenciale të institucioneve, që ato të bëhen më transparente, më efektive dhe të përfaqësojnë të gjitha komunitetet e shoqërisë civile, për të luajtur një rol balancues më efektiv në jetën e përditshme, që rinia t'a ndërtojë një të ardhme prosperuese dhe paqësore për Kosovën. Ky është një partneritet i vërtetë për të gjithë ata që janë dhe dëshirojnë të jenë të përfshirë në këtë proces për ta bërë Kosovën një vend më të mirë.

Kemi të njëjtat qëllime për Kosovën, qëllime që Kosova i ka për vetveten, dhe standardet e dëshmojnë këtë. Por në fund të këtij procesi implementues, jeni ju, populli i Kosovës, ata që do të jeni pronarët e vërtetë të Standardeve, dhe vetëm populli i Kosovës do të jetë përfitues i vërtetë i tyre.

*Ambasadori Paskal Fieski
Misioni i OSBE-së në Kosovë
Zëvendës i PSSP-së për ndërtim institucional*

DETAJE

Gazetë e publikuar nga OSBE-ja

OSCE HQ, 38000 Prishtinë / Priština Tel (+381-38) 500 162

Fax: (+381-38) 500 188

E-mail: osce-kosovo@omik.org

Botuesi:

Sven Lindholm

Kryeredaktorë:

Arni Snaevarr

Redaktorë:

Hasan Sopa (Detaje), Slavisha Mladenović (Detalji)

Disenji & faqosja:

Shpend Kada

Bashkëpunorët:

Edita Buçaj, Ardiana Gashi, Biserka Ivanović,
Karin Marmosler, Adnan Merovci, Augustin Palokaj,
Hartmut Pyner, Besnik Tahiri Fatime Lepaja,
Rexhep Krasniqi, Halide Sadiku, Mevlyde Salihu,
Ardiana Sejdiu

osce

Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

Me çka ka të bëjë standardi i parë ?

“Një Kosovë ku të gjithë – pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racën ose fenë – janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, armiqësi ose rreziqe dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë.”

nga Arni Snaevarr, OSBE

Ngritja e institucioneve demokratike është pa dyshim njëri nga standardet e para dhe më të rëndësishme për Kosovën. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara përsëriti mëbshtetjen e tij për planin ‘Standardet para Statusit’, që nënkupton përmbushjen e tetë standardeve para se të vendoset për statusin final të Kosovës. Plani për implementimin e standardeve për Kosovën, që është vënë në lëvizje në fillim të këtij viti, është një udhërefyes drejt këtij procesi. Standardi që ka të bëjë me funksionimin e institucioneve demokratike, përfshinë edhe dispozitat për mbajtjen e zgjedhjeve të drejta dhe të lira, ndihmon forcimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) dhe promovon krijimin e mediave profesionale dhe të përgjegjshme.

Njëra nga objektivat kryesore të standardeve është bërja e Kosovës me institucione dhe ligje që do ta afronin më afër evropës.

Zgjedhjet

Por çka do të thotë të keshë ‘institucione funksionale demokratike’? Zgjedhja e legjislacionit dhe Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse, me zgjedhje të lira, korrekte dhe demokratike, natyrisht se është shumë e rëndësishme. Në të vërtetë, për herë të parë, që nga viti 1999, një institucion vendor do të marrë përgjegjësinë për mbajtjen e zgjedhjeve. Brenda pesë viteve të fundit tri zgjedhjet e mbajtura në Kosovë kanë qenë një punë gati ekskluzivisht e mbikqyrur nga ndërkombëtarët (OSBE).

Mirëpo, edhe pse zgjedhjet janë të rëndësishme, vetëm mbajtja e tyre nuk është e mjaftueshme për të krijuar një shoqëri funksionale dhe demokratike.

Të gjitha komunitetet shërbehen dhe përfaqësohen

Një prej parimeve themelore të një qeverie demokratike është barazia e të gjitha komuniteteve. Për të përmbushur standardin e ‘institucioneve funksionale demokratike’, Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës duhet të sigurojnë se të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara në mënyrë proporcionale në të gjitha nivelet e IPVQ. Gjuhët zyrtare duhet të respektohen në të gjitha institucionet e qeverisë dhe shërbimet themelore publike, siç janë shëndetësia, shërbimet komunale dhe shkollimi duhet të jenë në dispozicion të të gjitha komuniteteve në Kosovë, pa asnjë diskriminim.

Nevoja për strukturat paralele duhet të re-



Standardet synojnë një qeveri të zgjedhur demokratike...që përfaqëson interesat e të gjitha komuniteteve të Kosovës

duktohet me shtimin e shërbimeve për të gjithë dhe ato duhet të shpërndahen ose të integrohen në strukturat e IPVQ-së.

Shërbimet civile duhet të jenë profesionale, të paanshme dhe të përgjegjshme, duhet që të kenë anëtarë të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe të përfshijnë një numër domethënës të grave. Synimi i standardit është që gratë të marrin pjesë në institucionet e IPVQ-së në atë shkallë që është e barbartë ose kalon nivelin e vendeve në rajon si dhe interesat e tyre të reflektohen plotësisht në politika dhe legjislacion.

IPVQ-ja dhe qeveritë lokale duhet të marrin vendime dhe t'i miratojnë ato në mënyrë transparente, të përgjegjshme dhe demokratike. Duhet të ekzistoj kodet e mirësjelljes dhe procedura detyruese në mënyrë që të mundësojnë një qeveri transparente dhe të përgjegjshme.

Një përmbledhje e kësaj do të ishte: qëllimi i standardit është një qeveri e zgjedhur në mënyrë demokratike që administron në mënyrë të paanshme, transparente dhe të përgjegjshme, që përfaqëson interesat dhe nevojat e komuniteteve në Kosovë në të gjitha institucionet qeveritare.

Mediat dhe shoqëria civile

Nuk është e mjaftueshme që vetëm institucionet demokratike të bëjnë një demokraci funk-

sionale. Standardet nënvizojnë rëndësinë e mediave dhe të shoqërisë civile të pavaruar në një shoqëri demokratike.

Në një Kosovë demokratike duhet të ekzistojë një numër i mediave të shtypura dhe elektronike private dhe të pavaruara dhe që sigurojnë informata për të gjitha komunitetet. Duhet të krijohet një autoritet rregullativ i pavarur dhe efikas për media dhe gjuha e urrejtjes ose ndonjë formë tjetër e nxitjes duhet të dënohet nga udhëheqësit politik, autoriteti rregullativ i mediave dhe analistët të mediave. Mediat publike duhet të bëjnë një ndarje të drejtë të mjeteve të tyre dhe të programeve për të gjitha komunitetet.

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm dhe ka ndikim në ngritjen e zërit për interesat dhe brengat e qytetarëve para qeverisë. Shoqëria civile mund të punojë në mënyrë efektive si një partner kritikues dhe mbështetës i institucioneve të qeverisë së Kosovës – përfshirë këtu edhe kuvendin e Kosovës, IPVQ-në, autoritetet komunale dhe administratën civile. Standardet e pranojnë rëndësinë e organizatave joqeveritare, në veçanti të atyre që përfaqësojnë minoritetet. Ato duhet të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë të lirë në bazë të ligjit dhe individët të mund t'u bashkangjiten në mënyrë të lirë dhe pa asnjë diskriminim.



Standardet në media duhet ndarë nga politika, pra edhe nga standardet për statusin

Të gjithë kanë një qasje të gabuar saherë që përmendin pakicat dhe mediat në Kosovë duke e kufizuar këtë debat me informimin në gjuhën e tyre. Problemi në Kosovë është se në gjuhën e shumicës nuk raportohet shumë për problemet e pakicave ndërsa në gjuhën e pakicave as pas pesë viteve nuk është shkruar se çfarë i kishte ndodhur shumicës nën regjimin e Millosheviqit.

Nga: Augustin Palokaj

Ndonëse mediat në Kosovë, sikur gjithkund në botë, në njërin anë janë pasqyrim i gjendjes në shoqëri e në anën tjetër krijues të opinionit të po asaj shoqërie. Çfarëdo kushtëzimi i një zgjidhje politike me situatën e mediave është politizim dhe në këtë mënyrë edhe gabim. Prandaj, edhe përmendja e rolit të mediave në mesin e standardeve të cilat duhet plotësuar për të zgjidhur statusin e Kosovës është diçka kontraverze.

Në botën e zhvilluar nga e cila dëshiron të mësojë Kosova, nga e cila edhe vijnë zyrtarët që dëshirojnë ta bartin përvojën e tyre në Kosovë, mediat synojnë të ndahen nga politika, të jenë sa më të pavarura dhe të lira në komentet e tyre. Ato shpesh janë pasqyrë e shoqërisë sepse edhe roli i tyre është të pasqyrojnë atë që ndodh, por edhe janë një lloj mjeti edukativ dhe emancipues.

Megjithatë, në mesin e politikës së dizajnuar për Kosovën të pagëzuar me emërtimin 'standardet para statusit' dhe planin për implementimin e tyre, janë disa gjëra për mediat që duhet marrë seriozisht. Ato nuk kanë të bëjnë me kërkesën që komentet në medija të jenë në frymën multietnike, sepse askush nuk ka të drëjtë të caktojë se si duhet të jenë komentet, pasi që ato duhet të jenë të lira, por kanë të bëjnë me disa parakushte që do të ndihmonin në strukturimin e mediave, që është problem i madh në Kosovë.

Do të ishte qesharake sikur një ditë të del ndonjë zyrtarë ndërkombëtar dhe të thotë se "Kosova nuk e meriton zgjidhjen e statusit të saj për shkak se disa media bëjnë komente të papranueshme".

Situata në mediat e Kosovës është më komplekse. Së pari, nuk mund të flitet në shumës për 'mediat e Kosovës', edhe pse këtë gabim e bëjnë shpesh zyrtarët ndërkombëtarë duke i futur të gjitha në një thes. Për secilin që ka mundësi të lexojë mediat nga i tërë rajoni është evidente se në Kosovë ka media që për nga standardi profesional janë shumë para mediave të vendeve tjera të rajonit. Sikurse që ka edhe media, raportimet e të cilave janë thjeshtë primitive, sepse fjala joprofessionale do të ishte tepër e butë për to.

Mediat janë të tilla sepse edhe shoqëria është e tillë, pra të politizuara dhe të varura e të ndikuara nga grupet e caktuara interesi,



"Mediat e Kosovës kanë edhe një konflikt gjeneratash të gazetarëve që punojnë në to dhe atë jo aq për nga mosha sa për nga përvoja dhe botëkuptimet."

shpesh të partive politike. Dhe këtu Kosova nuk është kurrfarë fenomeni sepse që kur ekzistojnë politikanët dhe mediat, të parët orvaten të ndikojnë sa më shumë që mundën në këto të dytat.

Mediat e Kosovës kanë edhe një konflikt gjeneratash të gazetarëve që punojnë në to dhe atë jo aq për nga mosha sa për nga përvoja dhe botëkuptimet. Një gjeneratë e re e gazetarëve, e kalitur duke punuar shpesh edhe me gazetarë të huaj gjatë krizës dhe luftës në Kosovë, me njohje të gjuhëve të huaja dhe të teknologjisë së re, tashmë bartë një barrë të madhe në gazetarinë Kosovare. Kësaj gjenerate, të cilës regjimi i Millosheviqit ua mohoj mundësinë e shkollimit, në një masë i mungon shkollimi sistematik dhe tash duhet ta kompenzojnë.

Gjenerata tjetër më e vjetër e gazetarëve ishte përjashtuar nga puna në fund të viteve tetëdhjeta të shekullit të shkuar. Duke qenë të pa punë për më shumë se dhjetë vite, tash e kanë të vështirë të gjinden në rrethanat e reja politike, shoqërore dhe teknologjike pasi që

përvoja e tyre vjen nga koha kur gazetari përceptohej si një punëtor shoqëroro-politikë. Këto dy gjenerata, secila me një lloj hendikepi më tepër për shkak të rrethanave e jo për fajin e tyre, sot bashketojnë në skenën kosovare.

Ky është një fenomen me të cilin askush nuk është marrë seriozisht në Kosovë. Po të ishin marrë seriozisht, atëherë do ta kuptonin se gabimet në mediat e Kosovës nuk janë rezultat i qëllimeve por më shumë i mosdijes. Një shtresë e gazetarëve edhe sot e ka të vështirë ta ndajë punën e tij të gazetarit prej detyrës së një politikani dhe si të tillë i përcepton edhe opinionin. Prandaj kryesisht, me disa përjashtime, kemi një lloj servilizmi ndaj politikës dhe një gazetari protokolare, jokritike.

Për fat të keq, një gazetari të tillë preferon edhe administrata ndërkombëtare në Kosovë e interesuar që të jetë sa më largë kritikës për punën e saj dhe raportet për punën e tyre ose bëhen të njëanshme ose janë kritika të ngarkuara me paragjykime negative.

Gabimi në qasjen e administratës ndërkombë

bëtare në Kosovë që prej fillimit e deri me sot ka qënë se gjithçka në Kosovë e shikon nga prizmi ndëretnik, duke mos kuptuar fenomenin e zhvillimit profesional të mediave.

Në anën tjetër, mungesa e gadishmërisë së vet gazetareve që të jenë solidarë dhe të krijojnë ndjenjën e përgjegjësisë profesionale përmes kodekseve të shoqatave të tyre, u ka lënë hapsirë që me qështjen e etikës gazetareske të mirren të tjerët.

Është e vërtetë se Kosova nuk mund të shkojë përpara pa dëshmuar se ka një shoqëri të zhvilluar e tolerante, sidomos ndaj pakicave, sikur është e vërtetë se mediat luajnë një rol të madh në krijimin e kësaj tolerance.

Të gjithë kanë një qasje të gabuar saherë që përmendin pakicat dhe mediat në Kosovë duke e kufizuar këtë debat me informimin në gjuhën e tyre. Problemi në Kosovë është se në gjuhën e shumicës nuk raportohet shumë për problemet e pakicave ndërsa në gjuhën e pakicave as pas pesë viteve nuk është shkruar se çfarë i kishte ndodhur shumicës nën regjimin e Millosheviqit.

Është vështirë të shohish ndonjë reportazh në mediat e Kosovës në gjuhën shqipe për problemet e përditshme të serbëve në enklavën e Gorazhdevcit që jetojnë në geto.

Serbët në anën tjetër informohen përmes mediave të Beogradit e ato kryesisht raportojnë në mënyrë të njëanshme dhe me paragjykime ndaj shqiptarëve, që e kanë dëshmuar edhe analizat e vet disa organizatave qytetare në Serbi.

Në këtë mënyrë, duke u interesuar vetëm që pakicat të kenë sa më shumë media në gjuhën e tyre, duke lënë anash përmbajtjen e asaj se çfarë dhe sa raportohet në gjuhën e njërës për problemet e tjetrit, vetëm ndihmohet segregimi i ri etnik në Kosovë, me apo pa vetëdije.

Zhvillimi i mediave dhe profesionalizimi i tyre në Kosovë është duke ndodhur dhe vetëdija e gazetarëve është duke u zhvilluar. Por tepër ngadalë po krijohen kushtet për media profesionale, kritike dhe të lira në Kosovë.

Ajo që menjëherë dhe pa kusht mund të kërkohet nga mediat e Kosovës është më shumë përgjegjësi për punën e tyre. Kjo përgjegjësi, nëse nuk mund të sigurohet me profesionalizëm, duhet të sanksionohet me ligj edhe pse është mjeti i fundit, e ligjet nuk i krijojnë gazetarët.

“Është vështirë të shohish ndonjë reportazh në mediat e Kosovës në gjuhën shqipe që flasin për problemet e përditshme të serbëve... Serbët në anën tjetër informohen përmes mediave të Beogradit e ato kryesisht raportojnë në mënyrë të njëanshme dhe me paragjykime ndaj shqiptarëve”



Zgjedhjet sipas Standardit numër një

Nga Ardiana Gashi dhe Karin Marmsoler

Zgjedhjet

- Zgjedhjet janë të rregullta, transparente, të lira dhe të drejta, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, duke mundësuar pjesëmarrjen e plotë dhe të qetë të të gjitha komuniteteve dhe grupeve etnike.
- Personat e zhvendosur dhe refugjatët vazhdojnë të jenë plotësisht të përfshirë në procesin zgjedhor në Kosovë dhe ata ndihmohen për të votuar.
- Zgjedhjet administrohen nga trupi i pavarur, përfaqësues dhe multietnik, Komisioni Qëndror Zgjedhor.
- Një sërë partish politike demokratike garojnë në zgjedhje.
- Një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore që mbulon operimin dhe financimin e partive politike është aprovuar dhe zbatuar.

Organizimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve është një nga detyrat më të rëndësishme që ka mandate i Misioni të OSBE-së në Kosovë më saktësisht departamenti i zgjedhjeve. Që nga themelimi i Misionit të OSBE-së më 1999 janë mbajtur tri palë zgjedhje, dy palë komunale dhe një palë parlamentare. Nga aspekti ligjor këto zgjedhje janë udhëhequr nga Komisioni Qëndror Zgjedhor, por OSBE-ja kishte rolin e administrimit të të gjitha aspekteve operacionale të ciklit zgjedhor. Vëzhgues ndërkombëtarë dhe vendorë, duke i përfshirë përfaqësuesit e Këshillit të Evropës dhe Parlamentit Evropian, i kanë njohur të tre palë zgjedhjet, të kenë qenë në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për zgjedhje transparente, të lira dhe të drejta.

Për zgjedhjet parlamentare të vitit 2004, Misioni i OSBE-së i kryen përgjegjësitë e veta me një ndryshim të dukshëm në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Aktivitetet operuese ndahen me një trup të ri vendor drejtues i zgjedhjeve, 'Sekretariati i Komisionit Qëndror Zgjedhor' (SKQZ), që është një autoritet jopolitik teknik. Në të ardhmen, SKQZ-ja pritet t'a marrë përsipër tërë operacionin zgjedhor. Përvoja e tashme, ku OSBE-ja dhe SKQZ-ja bashkëpunojnë në një partneritet të ngushtë, ka për qëllim garantimin e udhëheqjes së qëndrueshme dhe demokratike të zgjedhjeve në Kosovë.

Aspekti qenësor i zgjedhjeve demokratike, e kështu edhe i Standardit nr.1, qëndron në përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve votuese, mbrenda dhe jashtë Kosovës. Në zgjedhjet e mëparshme, Mis-

ioni i OSBE-së u ka dhënë rast të gjithë të shpërngulurve dhe refugjatëve të hedhin votën e tyre me postë ose, siq është rasti në Serbi dhe Mal të Zi, nepërmjet votimit individual. Në zgjedhjet e këtij viti, operacioni me postë do t'a mbulojë tërë votimin jashtë Kosovës, duke përfshirë Serbinë dhe Malin e Zi. Një fushatë e gjërë e informimit publik, e udhëhequr nga SKQZ-ja do të mbahet me qëllim të informimit të votuesve jashtë Kosovës në lidhje me mënyrën e votimit. Sipas Rregullores së re të UNMIK-ut 2004/11, partitë politike janë të obliguara t'i kryejnë një numër të madh të obligimeve në mënyrë që të rritet demokracia e mbrendshme dhe transparencja.

Rregullorja kërkon që statutet e partive të sigurojnë standardet minimale për demokracizim e mbrendapartiak që përfshijnë pjesëmarrjen demokratike të anëtarëve të partisë në përzgjedhjen e kandidatëve zgjedhorë të partisë për zgjedhjet parlamentare dhe komunale. Statutet e partive politike duhet t'i reflektojnë procedurat sipas të cilave qytetarët anëtarësohen ose pushojnë të jenë anëtarë të një partije si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të partisë. Statutet gjithashtu duhet të përfshijnë procesin vendimarrës në ndryshimin e statutit apo programin e partisë politike si dhe shpërbërjen e partisë. Partia politike duhet t'i sigurojë procedurat në zgjedhjet e mbrendshme të kryetarit të partisë, të anëtarëve të organeve

më të larta ekzekutive apo të çdo anëtarit tjetër të zgjedhur të partisë. Përveç çështjeve tjera, partia politike duhet të themelojë një organ që do të shërbejë si një mekanizëm për zgjidhjen e konflikteve të mbrendshme të partisë që kanë të bëjnë me interpretimin e statutit të partisë.

Të gjitha partitë e regjistruara politike duhet të aprovojnë statute që janë në pajtim me kërkesat e përmendura deri më 30 qershor të vitit 2004. Në ndërkohë, ato parti që nuk i kanë zgjedhur kryetarët dhe organet më të larta ekzekutive duhet t'a bëjnë këtë para 15 korrikut 2004 në sesionin e përgjithshëm të asamblesë.

Për më tepër, Rregullorja e re prezenton sistemin e ri të raportimit financiar dhe mbajtjes së shënimeve, të ngjashëm me shumë sisteme evropiane.

Tani kërkohet që çdo parti e regjistruar politike, të mbajë shënime dhe të zbulojë të gjitha kontributet që kalojnë vlerën prej 100 euro. Asnjë individ nuk guxon t'i japë më shumë se 20.000 euro një partie mbrenda një viti kalendarik. Çdo parti e regjistruar politike nuk pranon kontributin e tërthortë nepërmjet një individi nga mjetet, prona apo shërbimet e palës së tretë. Nga partia politike do të kërkohet të dorëzojë raport të hollësishëm financiar, çdo gjashtë muaj duke filluar nga një shtatori 2004. Raporti do të kërkojë nga partitë politike t'i paraqesin të gjitha ardhurat, shpenzimet, mjetet dhe detyrimet.



Bashkëpunimi në mes të SKQZ-së dhe OSBE-së në zgjedhjet 2004 është edhe një hap para drejt një menagjimi të qëndrueshëm dhe demokratik të zgjedhjeve në Kosovë

Përmbushja e një standardi vendorë organizojnë zgjedhjet 2004

Nga: Adnan Merovci

Në fund të vitit 2003 është themeluar organi vendor për menaxhimin e zgjedhjeve me status përhershëm, i pavarur, i pa influencuar nga politika që quhet, 'Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve' (SKQZ).

SKQZ-ja është krahu operativ i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që është përgjegjës për zhvillimin, organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve, të lira, të ndershme, transparente dhe në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, në tërë Kosovën dhe për tërë qytarët e saj me të drejtë vote.

Zgjedhjet parlamentare që do të mbahen në tetor 2004, për her të parë do të organizohen nga vendorët. OSBE-ja në operacionet që do t'i kryej SKQZ-ja do ta ketë rolin monitorues dhe këshillëdhënës.


Përveq tjerash, SKQZ-ja do të mirret edhe me organizimin e vendvotimeve dhe operacioneve të tjera në ditën e zgjedhjeve në teren. Kjo do të arrihet në bashkëpunim të ngushtë me Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe përkrahjen e plotë nga administratat komunale.

KKZ-të të koordinuara dhe udhëhequra nga zyrtari ekzekutiv komunal për zgjedhje, do të drejtojnë aktivitetet zgjedhore në qendrat e votimit të komunave përkatëse. Administrata komunale aktivisht do të përkrahin dhe ndihmojnë KKZ-të me resurse njerëzore, materiale dhe logjistike.

Me qëllim të zbatimit të operacioneve zgjedhore, SKQZ-ja do të bashkëpunojë ngushtë edhe me institucionet e përkohshme të vetëqeverisëse (IPVQ), si – Ministrinë e Shërbimeve Publike, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Gjithashtu, do të ketë bashkëpunim edhe me zyrën e Kryeministrit, për përkrahje gjithëpërfshirëse dhe informim publik. Tani më veq janë vendosur kontaktet e para me IPVQ-në dhe është vërejtur një nivel i lartë i mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe përkrahjes.

Zgjedhjet janë Standardi i parë për Kosovën. SKQZ-ja figuron edhe në planin për implementimin e standardeve. Kjo edhe më tepër na obligon që të jemi më ekspeditiv dhe më profesional në punën tonë.



Zgjedhjet 2004 janë të parat të organizuara nga vendorët

Theks të veçantë duhet kushtuar, përfshirjes së të gjitha bashkësive etnike në zgjedhjet e sivjeme. Këtë mendojmë ta arrijmë me punë dhe vetëm me punë. Strategjia jonë bazohet në krijimin e një ambientit dhe atmosfere të besimit në punën tonë, në mënyrë që të gjithë votuesit të votojnë dhe vota e secilit të jetë e vlefshme. Këtë do ta arrijmë me personelin e SKQZ-së që është shumetnik dhe me informim publik të drejtë dhe efikas. Poashtu, SKQZ-ja ndihmohet, trajnohet dhe këshillohet nga departamenti i zgjedhjeve (DZ) të OSBE-së. Bashkëpunimi në mes të SKQZ-së dhe DZ të OSBE-së është, ka qenë dhe do të jetë moto e strategjisë sonë të përbashkët për arritjen e qëllimeve tona.

SKQZ-ja ka një personel të përhershëm prej afërsisht 20 të punësuarve në nivel qendror në Prishtinë dhe 30 zyrtarë ekzekutiv komunal për zgjedhje të vendosur nëpër komuna. Meqenëse ndodhemi në vitin e zgjedhjeve, kemi edhe personel të përkohshëm. I gjithë personeli, është i obliguar t'i nënshtrohen rregullores së shërbimit civil të Kosovës.

SKQZ-ja financohet nga buxheti i konsolid-

uar i Kosovës dhe udhëheqet nga kryeshefi ekzekutiv, dhe zëvendësi i tij.

SKQZ-ja për zgjedhjet e sivjeme mbanë përgjegjësi në fushat e mëposhtme të aktiviteteteve të zgjedhjeve:

- Çertifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur,
- Trajnimin e personelit të komunave për vendvotime,
- Menaxhimin e qendrave të votimit,
- Ruajtja dhe shpërndarja e materialeve të zgjedhjeve,
- Prodhimin e fletëvotimeve,
- Informimin publik,
- Programet për akreditim të vëzhguesve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë,
- Zhvillimin e aktiviteteteve zgjedhore brenda Kosovës.

OSBE-ja do të vazhdojë të ketë rolin monitorues dhe këshillëdhënës në operacionet e lartpërmendura.



Nuk ka demokraci pa qeveri të fortë lokale

Nga Hartmut Pyner, OSBE

Vetëqeverisja lokale demokratike është një nga gurthemet e demokracisë evropiane. Derisa ndërtesa të mëdha të parlamenteve, si ndërtesa e parlamentit në lumin Temz në Londër, janë simbole të njohura të demokracisë në Evropë dhe në mbarë botën, shumica e çështjeve ditore të qytetarëve shqyrtohen në ndërtesa shumë më pak spektakulare, si në 'Town halls', 'Mairies' dhe 'Rathaeuser' të Evropës. Përderisa parlamentet, qeveritë dhe ministrat vendosin për çështje nacionale në mënyrë demokratike, asamblatë komunale, kryetarët e komunale dhe nëpunësit civil kujdesen për ambientin në të cilin jetojnë qytetarët. Shumë nga ndërtesat e asambleve komunale këtyre ditëve janë jo vetëm ndërtesa të qeverive lokale por edhe monumente historike, shumë nga to datojnë para disa shekujve.

Ideja që banorët e një qyteti, qyteze a fshati dinë më së miri se si të shqyrtojnë shqetësimet në ambientin e tyre, në Evropë është me mijëra vite e vjetër. Por, sot ka një konsensus në Evropë, se pa një vetëqeverisje lokale të fortë si një bazë, institucionet demokratike nuk mund të ekzistojnë. Një kocept për këtë ide është definuar në Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen lokale.

Koncepti është 'parimi i subsidiaritetit' që do të thotë se qeveritë duhet të veprojnë gjithmonë në nivelin më të ulët të mundshëm. Përvoja evropjane tregon se kjo ofron vendimarrje të arsyeshme dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve. Nëse një çështje diskutohet nga ata që janë drejtpërdrejt të prekur, gjasat janë më të mëdha që njerëzit që dinë më së shumti për këtë çështje të përfshihen në vendimarrje, dhe kjo në të njëjtën kohë siguron motivim të lartë për të gjetur zgjidhjen më të mirë. Ata që janë drejtpërdrejt të përfshirë në vendimarrje do të përfitojnë nga një vendim i mirë, ose do të duhet të bartin pasojat e këqija të një vendimi të pa mend, apo edhe më keq, mosmarrjen fare të një vendimi.

Është dëshmuar poashtu se një qeveri vetëqeverisëse lokale funksionale demokratike është në të mirë të shoqërisë si tërësi. Me funksionimin demokratik të qeverisë lokale, bëhet e panevojshme të vërshohen ndërtesat qeveritare të mëdha në qendrat e largta me miliona probleme lokale pasi që këto probleme zgjidhen nga vetë popullata lokale. Përfundimisht, një shtet me një sistem të mirë të vetëqeverisjes lokale është një shtet efikas.

Për më tepër, sot pranohet publikisht se politika lokale është djepi i një burrështeti të madh dhe i partisë politike në shkallë nacionale, si dhe liderëve të shoqërisë civile. Në mënyrë të veçantë, është terren për testim për liderët dhe politikanët e rinjë. Kush është i aftë për të dëgjuar bashkëqytetarët e vet, kush tregon talent për të bindur fqin për një ide të mirë, kush e tregon veten me sukses në një debat politik lokal, kush mund të organizojë një projekt lokal, ai mund të mësojë në procesin si të udhëhiqet një rajon apo shtet në mënyrë demokratike. Mundet, por nuk është e garantuar. Por kush nuk ka provuar kurrë t'i rregullojë gjërat para derës së shtëpisë së vet, marrja e përgjegjësisë për disa qindra ose mijëra njerëz, ka më shumë gjasa të përfundojë keq kur ai të udhëheq një zyre të nivelit më të lartë. Gati të gjithë udhëheqësit e suksesshëm në botën perëndimore kanë filluar të mirren me politikë në një sallë të qytetit ose qarkut, si kryesues të shoqatave apo klubeve lokale.

Konventa, me të cilën mbrohen këto parime për anëtarët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës është "Karta e Vetëqeverisjes Lokale" e Këshillit të Evropës. Duke respektuar traditat e ndryshme lokale, nënshkruesit e kësaj karte i janë bashkuar parimit të suksesshëm për t'i dhënë nivelit lokal sa më shumë funksione qeveritare dhe për ta afruar sa më shumë këtë nivel lokal me popullin, dhe në të njëjtën kohë për ta përfshirë popullatën lokale sa më shumë që të jetë e mundur.

Standardet për Kosovën parashohin sjelljen e dispozitave të "Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale" në Kosovë. Në kapitullin "funksionimi i institucioneve demokratike" të standardeve është bërë e qartë se "Të gjitha komunitetet përfaqësohen në mënyrë proporcionale në të gjitha nivelet e...IPVQ-ja dhe qeveritë komunale vendosin dhe miratojnë legjisllacionin në mënyrë të hapur, të përgjegjshme dhe demokratike."

Kjo do të thotë se komunat e Kosovës duhet të kenë përgjegjësi për të siguruar se të gjithë banorët pavarësisht nga gjuha e tyre amtare mund të marrin pjesë pa asnjë diskriminim në marrjen e vendimeve për çështje lokale, jo vetëm përmes zyrtarëve të zgjedhur por edhe përmes angazhimit të tyre personal.

Në pranverën e vitit 2004, Kosova bëri hapat



"Ideja që banorët e një qyteti, qyteze a fshati dinë më së miri se si të shqyrtojnë shqetësimet në ambientin e tyre, në Evropë është me mijëra vite e vjetër"

e parë në këtë drejtim, por akoma ka shumë për tu bërë. Retë e së kaluarës janë akoma pezull dhe kërcënojnë të errësojnë edhe të ardhmen. Institucionet e përkohëshme lokale të vetëqeverisjes janë vendosur, por shpirti mungon. Kufinj të komunal në Kosovë janë akoma të njëjtë si nën regjimin e Jugosllavisë socialiste, të bëra sipas teorisë së ideologut socialistit Edvard Kardelj. Kjo i bënë ato entitete me një mesatare prej 80,000 banorëve, 20 herë më e madhe se në Evropën qendrore. Kjo e bënë të pamundur krijimin e një marrëdhënieje të afërt në mes të banorëve dhe zyrtarëve komunal, e cila do të ofronte vendime efektive dhe shërbime të mira. Për këtë arsye, Standardet këshillojnë fuqishëm për të studiuar dhe mudësisht për të implementuar raportin për reforma për vetëqeverisjen lokale të përpiluar nga misioni për decentralizim i këshillit të evropës, i krijuar rishtazi. Misioni të cilit institucionet e konsideron veten si mbrojtës të demokracisë lokale në Evropë.



Anëtarët e asambleve komunale, si dhe nëpunësit civil, shpeshherë e shohin veten si përfaqësues të partive politike të tyre të udhëhequra nga politikanë të fuqishëm, e jo si mbrojtës të dëshirave dhe interesave të fqinjëve të tyre. Edhe kjo është trashëgim nga kohërat socialiste. Njeriu në rrugë shumë shpesh ndihet i injoruar kur politikanët e shohin vetveten të ngatërruar në diskutime të pafundme për karriga dhe pozita, dhe duke ia hedhur njëri tjetrit. Dhe kur diskutohen çështjet që e shqetësojnë atë, që shpeshherë ndodh në qarqe të mbyllura me dyer të mbyllura. Kjo është një pasojë e një përzierje jo të shëndoshë të trashëgimisë nga regjimi socialist në njërin anë, dhe në anën tjetër, zakonet tanimë të vjetruar të fshehtësisë.



Standardet e theksojnë rëndësinë e përdorimit të lirë të gjuhëve zyrtare dhe përfaqësim të drejtë të të gjitha komuniteteve.

Qytetet dhe fshatrat e Kosovës duhet të jenë shtëpi të banorëve të Kosovës të të gjitha gjuhëve dhe komuniteteve. Pakicat mund të marrin pjesë lirshëm dhe në mënyrë të plotë në demokracinë dhe shërbimet lokale vetëm nëse krijohet ambienti ku gjuha e secilit mund të përdoret lirshëm dhe ku të gjitha komunitetet përfaqësohen drejtë në strukturat komunale. Si pasojë, standardet theksojnë përdorimin e lirë publik të të gjitha gjuhëve zyrtare dhe përfaqësim të drejtë të të gjitha komuniteteve në të gjitha nivelet dhe ofrim jodiskriminues të shërbimeve komunale. Kjo nuk i ofron askujt privilegje të tepruara. Kjo vetëm siguron se në një shoqëri tradicionalisht shumë gjuhësore, secili pjestarë mund të lexojë dhe shprehet në gjuhën të cilën e zotron më së miri, në gjuhën e vet. Kjo do të thotë që secili është i barabartë para ligjit. Trashëgimia e keq

e Kosovës në konfliktet etnik dhe mungesa e gadishmërisë për ta tejkaluar atë, është ende një pengesë e madhe në këtë drejtim dhe e bllokun rrugën për tu bërë një nga rajonet magjepsëse në Evropë ku kjo është praktikë e përditshme, siq është Suedtiro/Alto Adige në Itali, Bruxelles/Brussel në Belgjikë apo Schlesëig/Slesvig në Danimarkë dhe Gjermani.

Është folur dhe lexuar shumë për strukturat paralele serbe. Sidoqoftë, serbet e Kosovës do të vazhdojnë t'i shohin ato të domosdoshme pasi që nuk ndihet të sig-

urtë dhe të trajtuar në mënyrë të barabartë në strukturat e Kosovës. Se kjo nuk është kuptuar në shkallë të gjerë është habitëse, veçanërisht duke patur parasysh faktin për ekzistimin e strukturave paralele të shqiptarëve jo shumë moti.

Sikur në shumë fusha tjera standardet nuk imponojnë asgjë në qeveritë lokale; por ato vetëm specifikojnë çka duhet të arrihet për të përmirësuar jetë e të gjithëve në Kosovë, si dhe për të inicuar bisedimet për statusin final. Ato janë udhërrëfyes për Kosovën drejt ekzistencës normale evropjane.



Pjesëmarrja e femrave është standard i yni

Standardet për Kosovën janë udhërrëfyes për zyrtarët e qeverisë së Kosovës dhe qytetarët e saj. Në çdo shoqëri moderne, roli dhe kontributi i femrave në funksionimin e institucioneve demokratike është i rëndësishëm dhe domethënës. Sipas Standardeve shërbimi civil duhet të jetë profesional, i paanshëm dhe i besueshëm, përfaqësues i të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe(duhet) të përfshijë...një përqindje të dukshme të femrave." Përveç kësaj: "Pjesëmarrja e femrat në institucionet e IPVQ-së duhet të në shkallë të barabartë ose edhe më i lartë me kuotat e vendeve në rajon dhe se interesat e femrave të reflektohen plotësisht në politikën dhe legjislaturën e tyre".

nga Biserka Ivanoviq, OSBE

Kur flasim për rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të femrave në strukturat vendimarrëse dhe përfaqësimin e tyre në to, teksti në vazhdim është një informim i shkurtër për mekanizmat e barazisë gjinore në Kosovë, që tregojnë pjesëmarrjen e dukshme të femrës në organet vendimarrëse dhe përfaqësimin e tyre në ato struktura. Në zyrën e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), është një ligj mbi barazinë gjinore i propozuar nga komisioni për barazi gjinore, i cili pritet të nënshkruhet dhe të shpallet. Në secilën ministri janë caktuar personat kontaktues për çështjen gjinore, madje edhe në zyrën e kryeministrit. Në nivelin vendor, zyrtarë për çështje gjinore janë caktuar në secilën komunë dhe janë formuar Komisione për barazinë gjinore në 15 prej 30 komunave.

Në vitin 2003, palët pjesëmarrëse që kanë të bëjnë me barazinë gjinore kanë zhvilluar një 'Plan Kombëtar të Veprimit' me rekomandime dhe veprime që duhet të ndërmerret nga akterët të ndryshëm duke përfshirë këtu IPVQ-në, me qëllim të njohjes së çështjeve gjinore

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrave (CEDAW), është pjesë e kornizës kushtetuese të Kosovës. Ligjet e zbatueshme për çështjen gjinore dhe rregulloret, gjithashtu e formojnë një pjesë të legjislacionit të Kosovës. IPVQ-së dhe akterët tjerë kryesor mbajnë përgjegjësinë themelore për përbushjen e objektivave të çështjes gjinore.

Palët pjesëmarrëse ndërkombëtare dhe vendore bëjnë përpjekje ta mbështesin punën e bërë mirë deri tash në këtë fushë. Misioni i OSBE-së në Kosovë me rregulloren për zgjedhje ka siguruar kuotën prej 30% të përfaqësimit për femra në organet vendimarrëse. Femrat në qeveri mund të kenë fjalën e vet gjithashtu dhe të ndikojnë në mënyrë më pragmatike në procesin e zhvillimit të politikave.

Misioni i OSBE-së në Kosovë në projekte, programe dhe planet e veta strategjike merrë parasysh rrjedhat kryesore për çështjen e barazisë gjinore dhe çështjet që kanë të bëjnë me te. Aktivitetet për trajnim gjithashtu synojnë të zgjerojnë njohurinë dhe përmirësojnë shkathtësitë për përbushjen e detyrave.

Vitin e kaluar, Rrjeti i Grave të Kosovës i Misioni të OSBE-së (gjithashtu mbështetur nga fushata e rrjetit STAR dhe UNIFEM),

bashkarishtë kanë implementuar një fushatë për krijimin dhe mbrojtjen e politikave të quajtur 'Puna e Partive Politike për Femra' që kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes për çështjet gjinore në secilën komunë të Kosovës dhe njëkohësisht të mbrojtje dhe llobojë për përfshirjen e këtyre çështjeve në platformat elektorale të partive politike.

Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNIFEM-i kanë punuar bashkë për të ndihmuar

themelimin e 'Komitetit për Barazi Gjinore' dhe në ngritjen e kuadrove profesionale të anëtarëve të tyre. Të dy këto organizatat do të vazhdojnë punën me këto organe...

Misioni do të vazhdojë të adresojë çështjet e barazisë gjinore përmes programeve të veta dhe projekteve të ndryshme edhe në vitete e ardhme. Standardet për Kosovën gjithashtu do të jenë direktiva për punën e OSBE-së në këtë çështje.



Përfaqësim i femrave në institucione duhet të jetë i barabartë ose edhe më i lartë me kuotat e vendeve në rajon.

Roli i shoqërisë civile në planin për implementimin e standardeve për Kosovën

nga: Besnik Tahiri, OSBE

Plani për Implementimin e Standardeve për Kosovën (PISK), ilustron mënyrën se si Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse (IPVQ) dhe Bashkësia Ndërkombëtare (BN) do të arrijnë qëllime të caktuara, të cilat duhet t'i përmbush shoqëria e Kosovës për tu bërë pjesë e familjes evropiane. Përmbushja e standardeve kërkon bashkëpunim të ngushtë në mes të gjitha institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare në Kosovë si dhe bashkëpunim më të gjerë rajonal, në veçanti sa i përket procesit të bisedimeve me Sërbinë dhe Malin e Zi. Plani, gati në tërësi, kërkon pjesëmarrje të plotë dhe angazhim konstruktiv të bashkëbiseduesve vendorë dhe ndërkombëtarë.

Gati 2500 Organizata Jo-Qeveritare janë të regjistruara në Kosovë, dhe këto OJQ mund të konkurrojnë si partner të rëndësishëm në këtë proces të ndërlikuar të implementimit të standardeve. Shoqëria civile mund të luaj rol shumë të rëndësishëm në procesin e ndërtimit të demokracisë dhe shoqërisë.

Në përgjithësi, shoqëria civile pritet të luaj një rol me ndikim të madh në përmbushjen e standardeve për Kosovën. Kryesisht, duhet

të krijohet një vetëdije publike për atë se çka do të thotë 'Standarde', me theks të veçantë në rini dhe rajonet rurale. Një nga detyrat me rëndësi është edhe lehtësimi më i mirë i bashkëveprimit në disa çështje kyçe në mes të IPVQ-së dhe BN-së. Për të siguruar kredibilitetin e procesit, duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me publikun në mënyrë që publiku të kuptojë se si 'standartet' ndikojnë në jetën e tyre në mënyrë pozitive. Përmes këtyre, kuadrot lokale për monitorimin e standardeve dhe procesin e integritetit duhet të forcohen. Shoqëria civile duhet të sigurojë përkrahje në ngritjen e kuadrove për organet qeveritare lokale dhe qëndrore përkrah obligimeve dhe veprime që rezultojnë nga standardet.

Ngjarjet e 17-20 marsit kanë treguar se duhet të intensifikohet përfshirja e akterëve të shoqërisë civile, dhe përpjekjet e tyre duhet të koncentrohen në aktivitetet që do të mund të shtonin respektin reciprok në shoqëri. Shoqëria civile është faktor qenësor në procesin e ndërtimit të mirëbesimit në mes të të gjitha komuniteteve. Gjithëpërfshirja e institucioneve jo-qeveritare është esenciale

për ndërtimin e demokracisë në Kosovë; përmbushja e standardeve është parakusht për fillimin e diskutimeve për statusin final të Kosovës në vitin 2005. Akterët e shoqërisë civile mund të angazhohen të monitorojnë dhe vlerësojnë progresin. Mirëpo, gjithashtu është me rëndësi ta ndihmojnë këtë proces, veçanërisht duke paraqitur modelin e partneritetit.

Shoqëria civile, në veçanti organizatat hulumtuese dhe institutet e specializuara, duhet të dizajnojnë programet e veta të cilat i referohen kornizës së 'Planit për Implementim të Standardeve' dhe duhet të kërkojnë partneritet me IPVQ-në, posaçërisht sa i përket institucioneve demokratike dhe funksionale, dialogut dhe bashkëpunimit rajonal.

Aktivitetet që kanë të bëjnë me zgjedhjet si p.sh. informatat për sistemin e votimit dhe materialet për ngritje të vetëdijes (për shembull posterë, fletushka, publikime etj.) mund të përkrahin mbledhjet publike ose tryezat e rrumbullakëta në mes të institucioneve vendorë, shoqërisë civile dhe partive politike. Në anën tjetër, mobilizimi i votuesve dhe avokimi qytetar mund të jenë pjesë përbërëse shumë të rëndësishme për pjesëmarrje në zgjedhje. Këto përpjekje mund të shtohen për të përfshirë programe të ndryshme trajnuese për edukimin e votuesve, dhe ofrojnë më shumë trajnime teknike se 'si të votojmë'.

Bashkëpunimi në mes të instituteve të specializuara ndërkombëtare dhe organizatave hulumtuese vendorë në lidhje me programet për ngritjen e kuadrove, në veçanti kur janë të përqëndruara në dialog dhe shkathësitë e negociatave, mund të jenë mjet i dobishëm për përfaqësuesit e IPVQ-së, pasi që standardet kërkojnë edhe këtë lloj aftësie.

Rinia (në veçanti ata që votojnë për herë të parë), femrat (posaçërisht vajzat e reja) dhe komunitetet tjera mund të konsiderohen si grupe me fokus të veçantë.

OJQ-të e ndryshme rinore dhe përfaqësuesit duhet të jenë më aktiv dhe më përgjegjës në Kosovën pluraliste dhe demokratike. Këto grupe mund të ndikojnë që rinia të kuptojë më mirë parimet themelore të demokracisë dhe të përmirësojnë pjesëmarrjen e tyre pozitive në procesin e ndërtimit të një qeverie me pjesëmarrje të barabartë. Kjo është mënyra për të kundërshtuar manipulimin politik.

Si përfundim, pa një angazhim të plotë të shoqërisë civile, në veçanti për temat si transparenca dhe përgjegjësi, do të jetë e vështirë të plotësohen Standardet për Kosovën.



Në Kosovë, me afërsisht 2500 OJQ të regjistruara, shoqëria civile mund të luaj rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e proceseve demokratike

Let's talk...



...about Koro